

KOMUNIKATË PËR SHTYP
Parlamenti i Parë Rural Shqiptar
28-30 shtator 2017
Tiranë, Shqipëri



Parlamenti i Parë Rural Shqiptar

Nisma e Parlamentit Rural - përpjekje e përbashkët e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural në partneritet me Universitetin Bujqësor të Tiranës, zhvillohet nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

Parlamenti i Parë Rural Shqiptar (PRSH) përfaqëson një platformë advokacie, ndërtimi kapacitetesh dhe rrjetëzim dedikuar zhvillimit rural. PRSH është instrumenti përmes të cilit partneriteti i kësaj nisme kërkojnë të influencojnë axhendën e zhvillimit rural në Shqipëri, me qëllim përsheptimin e proceseve reformuese në zhvillimin rural të vendit në përfrimin me politikën e BE-së të Zhvillimit Lokal të udhëhequr nga Komuniteti (CLLD).

Më datë 28-29 Shtator në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës, më shumë se 300 pjesëmarrës - përfaqësues të institucioneve qendrore dhe autoriteteve lokale, përfaqësues të misionëve të huaja diplomatike, stafit akademik, komunitetit të donatorëve, agjencive zhvillimore, shoqërisë civile, sektorit privat, shoqatave të fermerëve si dhe grupe të komuniteteve lokale rurale mbarë vendit- u mbledhën në Parlamentin e parë Rural shqiptar. Parlamenti ka në fokus trajtimin e një serie çështjesh të rëndësishme të zhvillimit rural si dhe ndarjen e praktikave pozitive dhe modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm rural nga ekspertët e vendeve të ndryshme europiane dhe ato në rajon si Sllovenia, Kroacia, Serbia Italia dhe Gjermania.

Sesioni final i PRSH 1 u zhvillua sot në Parlamentin e Shqipërisë, ku u ofruan mesazhet kyçe si nga zyrtarë të lartë ashtu dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale dhe nga Miqtë e Parlamentit Rural.

Leximi i DEKLARATËS së Përbashkët të Parlamentit të Parë rural Shqiptar 2017 – vizioni për komunitet rurale dhe një grup rekomandimesh që adresojnë përparësitë e zhvillimit të komuniteteve rurale në Shqipëri shënoi dhe përfundimin e Parlamentit. Ashtu sikundër në vendet anëtare në BE, PRSH do të mblidhet çdo dy vjet për të vlerësuar arritjet dhe sfidat përpara.

Parlamenti i Parë Rural Shqiptar (PRSH 1) bëri bashkë aktorë të zhvillimit rural me qëllim përsheptimin e axhendës rurale shqiptare, nëpërmjet zbatimit të një qasjeje me karakter gjithëpërfshirës, nga poshtë-lart dhe mbarëkombëtar. Përmes sesioneve plenare, paneleve të diskutimit, workshopeve dhe grupeve të punës, PRSH 1 krijoi një mundësi për diskutime dhe debate mbi çështje kyçe të zhvillimit rural, transferim njohurish dhe shkëmbim përvojash dhe praktikash pozitive nga rajoni e më gjerë, për rrjetëzime dhe kontakte si dhe për të iniciuar diskutime, bashkëpunime - në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Platforma e dakortësuar nga aktorët e interesit të këtij partneriteti kërkon të bëjë qeverisjen e institucioneve publike të sektorit në nivel kombëtar dhe lokal më proaktive dhe të përgjegjshme në promovimin e politikave dhe praktikave të BE-së në zhvillimin rural.

Pjesë e rëndësishme e Parlamentit rural ishte edhe lançimi i Grupit të Miqve të Parlamentit Rural – grup lobues dhe advokues që mbështet nismën e Parlamentit Rural dhe qasjen e Zhvillimit Lokal të udhëhequr nga Komuniteti (CLLD). Anëtarësia e grupit përbëhet nga personalitete të spikatura të zhvillimeve sociale-ekonomike të vendit duke përfshirë deputetë/ ish deputetë dhe ish ministra, diplomat e politikanë, akademik dhe sipërmarrës etj.